

MENAXHMENT - VITI I TRETË- SEMESTRI I

Menaxhimi Strategjik (0): 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme të koncepteve të menaxhmentit strategjik dhe aplikimit të tyre në praktikë, për arritjen e qëllimeve afatgjata – strategjike, të organizatës. Të analizojnë në detaje procesin e planifikimit strategjik të një biznesi nëpërmjet: vlerësimit të fuqive dhe dobësive; studimit dhe parashikimit të mjedisit të jashtëm të firmës; shanseve dhe kërcënimeve që i vijnë firmës nga mjedisi i jashtëm; hartimit të misionit, qëllimeve dhe objektivave të firmës; formulimit dhe zbatimit të planeve për arritjen e qëllimeve dhe objektivave; të zhvillojë aftësitë personale të studentëve për marrjen e vendimeve; të bëjë bashkërendimin e objektivave me vendimet e marra në kuadrin e strategjisë së firmës; t'i familjarizojë studentët me metodat e drejtimit të bizneseve, duke ilustruar teorinë me shembuj konkretë nga praktika e bizneseve botërore.

Financat Ndërkombëtare (0): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentëve t'u ofrohen njohuri për bilancin e pagesave dhe politikën makroekonomike, në ekonominë e tregut, në botën bashkëkohore, respektivisht për tregun devizor dhe bilancin e pagesave, tregtinë bankare, aspektet praktike në tregtinë bankare, koleksionin dhe kreditin dokumentar ndërkombëtar, financimin e tregtisë ndërkombëtare dhe agjencitë zyrtare për kredi eksporti dhe për financim të biznesit ndërkombëtar.

Vendosje në Biznes (0): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme nga: zhvillimi i teorive të vendosjes afariste dhe karakterin multidiciplinar të saj, zbatimin e koncepteve në praktikat elementare të vendosjes biznes, si moment kritik i procesit të menaxhmentit, se cila është rrjedha e procesit të vendosjes, se si ndikon rrethina me faktorët e saj në vendosje, se cilat janë modelet, metodat dhe teknikat e vendosjes, si të merren vendimet në kushtet e qarta dhe të paqarta, si të përdoren sistemet informative për mbështetjen e vendosjes.

Menaxhimi i Financiar (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisën me njohuritë themelore për konceptin e financave dhe drejtimit financiar në një biznes real (firmë). Do të din për mënyrat së si firmat marrin vendime mbi investimin, financimin dhe dividendin për të maksimizuar pasurinë e firmës (vlerën e aksioneve).

Kompetencat Ndërkulturore (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, rritja e aftësisë së studentit për të punuar në një ambient me kultura të ndryshme. Kursi ka për qëllim edhe masterizimin e kulturave, përfshirë racën nacionalitetin dhe gjinitë. Në disa tema diskutohet edhe rëndësia e medias sa u përket aspekteve kulturore.

Qeverisja e Korporatave [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njohohen me qeverisjet e korporatave, politikat dhe proceset qeverisëse të korporatave, të njohohen me politikat fiskale qeverisëse të Korporatave, të njohohen me faktorët kyç të qeverisjes së mirë të një korporate duke u bazuar në të hyrat, shpenzimet dhe çdo transaksion që kryhet brenda korporatave.

Financat Publike [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohurit e duhura për financat publike si disiplinë e ekonomisë, funksionet bazike të saj, se çka janë shpenzimet publike, të hyrat publike dhe tatimet, të njohohen me politikat fiskale të këtyre financave, doganat, taksat, kontributet, huat publike dhe buxhetin në përgjithsi. Të kuptojnë shpenzimet qeveritare, analizojnë politikat qeveritare etj.

MENAXHMENT - VITI I TRETË- SEMESTRI II

Kontabiliteti i Menaxhmentit (O): 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të marrin njohuri rreth kontabilitetit të menaxhmentit që përdoren në raste të ndryshme të vendimmarrjes. Ekzistenca e kontabilitetit të menaxhmentit është domethënëse për shkak të rolit të tij në marrjen e vendimeve afariste dhe zgjidhjen e shumë paqartësive afariste. Gjithsesi kuptimi themelor i kontabilitetit është ndihma në marrjen e vendimeve por në rastin e kontabilitetit të menaxhmentit theksi është në marrjen e vendimeve për shfrytëzues të brendshëm. Materialet janë të aplikueshme, jo vetëm për biznesin, por edhe për situata tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e informatave të efikasitetit dhe efektivitetit.

Menaxhimi i Operacioneve (O): 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentëve t`ju ofrohen njohuri hyrëse, mjaftë të kompletuara, të përmbledhura dhe të azhurnuara lidhur me vendin dhe rolin e menaxhimit të operacioneve në menaxhimin efikas të bizneseve. Që Studentët të fitojnë njohuri dhe të aftësohen për aplikimin praktik të kornizës teorike dhe profesionale që ka të bëjë me menaxhimin e operacioneve në bizneset bashkëkohore prodhuese dhe shërbyese.

Shkrimi Akademik dhe Metodologjia e Hulumtimit (O): 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njihen me rregullat themelore që kanë të bëjnë me metodologjinë e hulumtimit shkencor dhe shkrimit akademik. Qëllim kryesor i studimit të kësaj lënde është informimi shkencor dhe praktik dhe aftësimi teorik e praktik, për metodologjinë hulumtuese dhe shkrimin e punimeve profesionale dhe shkencore; konkretisht për përcaktimin e temës së punimeve profesionale; mbledhjen e burimeve bibliografike, strukturën e punimeve profesionale dhe shkencore; për metodologjinë shkencore të citimit të burimeve bibliografike; shkurarjen e punimit; renditjen e burimeve bibliografike, përgatitjen teknike të punimit dhe aspekte të tjera metodologjike që kanë të bëjnë me punimin.

Ekonometri (O): 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentëve t`ju ofrohet një paraqitje më e detajuar e koncepteve statistikore, krahasuar me ato të ofruara në lëndën bazë të statistikave; ofrimi i bazave të analizës ekonometrike, duke u fokusuar në metodologjinë e regresionit një, dhe shumëfaktorial (kryesisht metodën OLS); ofrimi i të kuptuarit gjithëpërfshirës të analizës së të dhënave mbi problemet ekonomike; fitimi i njohurive mbi një paketë kompjuterike për analizë të të dhënave.

Menaxhimi i Projekteve (Z): 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, të pajisë studentët me njohuritë themelore të menaxhimit të projekteve. Tregojnë aftësi praktike në vlerësimin e performancës së kompanisë në bazë të menaxhimit të projekteve; të përvetësojnë njohuritë teorike dhe praktike mbi vendimet rreth menaxhimit projekteve, njohuri rreth përpilimit të planeve, përdorimin e analizës SWOT lidhur me strategjinë e projekteve; të formojnë opinionin e tyre në lidhje me projektet.

Etika Biznesore [Z]: 5 ECTS

Qëllimet e kësaj lënde janë që studentët të fitojnë njohuritë e konsiderueshme në etikën e të bërit biznes. Të aftësohen në konceptet themelore të etikës, kodin standard të etikës në biznes, zhvillimi e koncepteve të etikës, të aftësohen në hartimin dhe zbatimin e disa rregullave të kodit të etikës, zgjidhjen e problemeve, konflikteve të interesit, ndershmërinë, paanësinë dhe komunikimin në proceset biznesore.

Punimi i diplomës dhe praktika: 10 ECTS